



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 428/ Prot.

Tiranë, më 10.02.2023

3

VENDIM

Nr. 3, datë 10.02.2023

**“PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË PRANIMIT DHE
TARIFAVE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË
STUDIMEVE, SPECIALIZIME AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR
VITIN AKADEMIK 2022-2023, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, miratuar me Vendim nr. 8, datë 04.02.2022 të Senatit Akademik, Vendimit nr. 98, datë 29.12.2022 "Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve...", të Senatit Akademik, si dhe propozimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2022-2023, janë 325 (treqind e njëzet e pesë) të ndara si më poshtë:

a) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	140;
b) Kuota pranimi nga Ministria e Drejtësisë	15;
c) Kuota pranimi nga Ministria e Brendshme	4;
d) Kuota të lira (të pa mbuluara)	161;
e) Kuota për transferim të studimeve nga institucione jashtë vendit	5;
2. Kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën l/a), b), c) dhe d), të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (5 kuota) shpërndahen nga Rektori i UMT-së, bazuar në propozimin e dekanateve sipas kërkesave të aplikantëve që vijnë nga institucione të tjera të arsimit të lartë, jashtë vendit, në programe specializuese afatgjata të njëjta apo të të njëjtit profil. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.

4. Aplikojnë, për programe studimi specializuese afatgjata, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.
5. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, miratuar me VSA nr. 8, datë 04.02.2022, të udhëzimit përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
6. Tarifa e aplikimit dhe konkurrimit në programet specializuese afatgjatë apo tarifa e aplikimit për transferim studimesh është 5000 (pesëmijë) lekë. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi është 115,000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë (tarifa e konkurrimit/aplikimit dhe tarifa e shkollimit është e njëjtë me tarifat e vitit të mëparshëm akademik). Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera arkëtohen sipas afateve dhe masës në përqindje të përcaktuara nga fakultetet përkatëse.
7. Studenti, i cilësuar, në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik, si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
8. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas pikës 1/b) dhe c), të këtij vendimi duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse. Studentët e shpallur fitues në kuotat sipas pikës 1/a), b) dhe c) të këtij vendimi lidhin kontratën me ministrinë përkatëse.

Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj, detyrimet, penalitetet në rast mosrespektimi të tyre, është përgjegjësi e ministrive përkatëse, të cilat kanë dhe detyrimin e njoftimit të kandidatit lidhur me këtë aspekt, para hapjes së procesit të aplikimeve.
9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i njësisë kryesore përkatëse të UMT-së, pa efekte buxhetore shtesë.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe i përcillet për zbatim Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe Ministrive përkatëse, si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore për vijimin e mëtejshëm të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GJATA



TABELA NR. 1: Shpërndarja e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, për vitin akademik 2022-2023

Nr.	NJËSIA KRYESORE	PROGRAMI I STUDIMIT	KUOTA TË MIRATUARA PËR V.A. 2022-2023	KUOTA NGA MSHMS	KUOTA MINISTRIA E BRENDSHME	KUOTA MINISTRIA E DREJTËSISË	KUOTA TË LIRA PAS PROPOZIMEVE TË MINISTRIVE
1	F. MJEKËSISË	ALERGOLOGJI DHE IMUNOLOGJI KLINIKE	10	2			8
2	F. MJEKËSISË	ANATOMI PATOLOGJIKE	5	2			3
3	F. MJEKËSISË	ANESTEZI-REANIMACION	20	10			10
4	F. MJEKËSISË	DIAGNOZË ME IMAZHE	12	12			0
5	F. MJEKËSISË	DERMATOLOGJI DHE VENEROLOGJI	5	-	1		4
6	F. MJEKËSISË	ENDOKRINOLOGJI	5	2		3	-
7	F. MJEKËSISË	GASTROHEPATOLOGJI	5	2			3
8	F. MJEKËSISË	HEMATOLOGJI	6	2			4
9	F. MJEKËSISË	KARDIOKIRURGJI	5	-			5
10	F. MJEKËSISË	KARDIOLOGJI	15	10	1	3	1
11	F. MJEKËSISË	KIRURGJI E PËRGJITHSHME	20	8			12
12	F. MJEKËSISË	KIRURGJI PLASTIKE, RIKOSTRUKTIVE DHE ESTETIKE	5	-			5
13	F. MJEKËSISË	LABORATOR KLINIK-BIOKIMIK	5	2			3
14	F. MJEKËSISË	MIKROBIOLOGJI	5	2			3
15	F. MJEKËSISË	MJEKËSI FAMILJE	20	10			10
16	F. MJEKËSISË	MJEKËSI INTERNE	12	12			0
17	F. MJEKËSISË	MJEKËSI LIGJORE	5	-		4	1
18	F. MJEKËSISË	MJEKËSI URGJENCE	15	15			0
19	F. MJEKËSISË	MJEKËSI TRANSFUZIVE	5	2			3
20	F. MJEKËSISË	NEFROLOGJI	5	2			3
21	F. MJEKËSISË	NEUROLOGJI	7	4	1		2
22	F. MJEKËSISË	NEUROKIRURGJI	5	-			5
23	F. MJEKËSISË	OTORINOLARINGOLOGJI	5	4			1
24	F. MJEKËSISË	OBSTETRIKË-GJINEKOLOGJI	10	8			2
25	F. MJEKËSISË	OKULISTIKË	5	2			3
26	F. MJEKËSISË	ONKOLOGJI	7	4			3
27	F. MJEKËSISË	ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJI	5	-			5
28	F. MJEKËSISË	PEDIATRI	20	15			5
29	F. MJEKËSISË	PNEUMOLOGJI	10	2	1		7
30	F. MJEKËSISË	PSIKIATRI	10	2		3	5
31	F. MJEKËSISË	PSIKIATRI E FEMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE	5	2			3
32	F. MJEKËSISË	REUMATOLOGJI	6	-			6
33	F. MJEKËSISË	SËMUNDJE INFEKTIVE	10	2			8
34	F. MJEKËSISË	SHËNDET PUBLIK	10	-			10
35	F. MJEKËSISË	TOKSIKOLOGJI KLINIKE	5	-			5
36	F. M. DENTARE	KIRURGJI MAKSILO-FACIALE	10	-		2	8
37	F. M. DENTARE	ORTODONCI	5	-			5

*5 kuota të miratuara për transferim të studimeve në Fakultetin e Mjekësisë, UMT, nga institucione jashtë shtetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 4617/Prot.
15

Tiranë, më 16.02.2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 12, datë 16.02.2023

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.3, DATË 10.02.2023 “PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TARIFAVE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, SPECIALIZIME AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË” TË SENATIT AKADEMIK TË UMT”

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, Vendimit nr. 3, datë 10.02.2023 "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit..." të Senatit Akademik, si dhe propozimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresë nr.10/2 prot., datë 14.02.2023, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Pas pikës 3 të Vendimit nr.3, datë 10.02.2023, shtohet pika 3.1 dhe 3.2 si më poshtë:
 - 3.1. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (10 kuota) janë në mbështetje të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 10/2 prot, datë 14.2.2023, bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Studenti transferohet nga programe specializimi afatgjatë, të ngjashme, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Kandidati që kërkon të transferohet sipas kësaj pike, duhet të marrë miratimin paraprak nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.
 - 3.2. 1 (një) kuotë transferimi për arsye mjekësore në zbatim të Vendimit nr.50, datë 29.04.2022 të Senatit Akademik të UMT-së.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për njohje dhe zbatim strukturave përkatëse.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GJATA

